# SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

## 1. Te dhena te pergjithshme mbi Shoqerine

Shoqeria "TRAJTIMI STUDENTEVE SHA", SHKODER. me NIPT K46517001T eshte person juridik shqiptar, me kapital themeltar 157,323,000 leke, i investuar teresisht nga Aksioneri i Vetem "Ministria e Financave dhe Ekonomise". Shoqeria "TRAJTIMI STUDENTEVE SHA", SHKODER ka seline ne Shkoder, ne adresen: Rr: Jeronim De Rada, Shkoder. Objekti i aktivitetit eshte "Akomodimi i studentave ne konvikte".
Administrator i shoqerise "TRAJTIMI STUDENTEVE SHA", SHKODER eshte z. Jetmir Lumaj.

## 2. Baza e Pregatitjes se Pasqyrave Financiare

### a. Menyra e Pregatitjes se Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare jane përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) te Permiresuara, të cilat janë të aplikueshme për pasqyrat financiare që mbulojnë periudha duke filluar nga 1 janar 2008. SKK-të janë aplikuar prospektivisht nga 1 janar 2008 pa ndryshuar pasqyrat krahasuese të vitit 2007.

### b. Ndryshime ne metodat e vleresimit kontabel

Rishikimi i vleresimit kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi (cmuarja) eshte kryer dhe ne cdo periudhe qe preket ne te ardhmen.

### c. Monedha Funksionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat

Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL), e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e Shoqerise. Informacioni financiar eshte paraqitur ne Leke.

### d. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proçesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të ketyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në vecanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË - TRAJTIMI STUDENTËVE SH.A. SHKODËR

## 3. Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel

### a. Instrumenta financiar

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

#### i. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuvalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimë të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare.

#### ii. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni per zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshtirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### iii. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### iv. Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diference midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

**v. Vlera e drejtë**

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, investimeve në pjesëmarrje, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

**vi. Të tjera**

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

**vii. Kapitali aksioner**

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale. Aksionet e preferuara të detyrueshmë me të drejtë riblerjeje klasifikohen si detyrime.

**b. Veprimet ne monedha te huaja**

Transaksioneve ne monedhe te huaj regjistrohen ne kontabilitet me kursin e dates se kryerjes se transaksionit.

Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj jane perkthyer ne pasqyren e bilancit me kursin e kembimit te Bankes se Shqiperise me 31.12.2016. Diferencat nga kursi i kembimit te lindura nga perkthimi njihen ne pasqyrene e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Asetet dhe detyrimet jo monetare qe maten me kosto historike ne monedhe te huaj perkthehen duke perdorur kursine kembimit ne daten e transaksionit.

Asetet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe paraqiten me vleren e drejte perkthehen me kursin e kembimit ne daten kur vlera e drejte eshte percaktuar.

Kursi i kembimit per dy monedhat e huaja kryesore me monedhen vendase sipas te Bankes se Shqiperise me 31.12.2017, ka qene respektivisht si me poshte:

1 Euro = 124.59 Lek
1 USD = 106.21.10 Lek

**c. Vleresimin e Gjendjeve te Inventarit.**

Inventaret regjistrohen ne kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle inventarin ne vendin dhe kushtet ekzistuese. Ne rastin e prodhimit te produkteve ne kosto perfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve te pergjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Koston e inventarit llogaritet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar

Gjendjet e Inventarit jane te vleresuara ne bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar kete vleresim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TRAJTIMI STUDENTEVE SH.A SHKODËR

d. **Vleresimi Aktiveve Afatgjata Materiale**

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM) paraqiten ne bilanc me vleren e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar. Shtesat e Aktiveve Afatgjata regjistrohen ne kontabilitet me koston e marrjes ose te prodhimit te tyre.

Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle ate aktiv ne vendin dhe kushtet ekzistuese.

Per llogaritjen e amortizimit jane aplikuar keto norma amortizimi:

| **Kategoria e AAM-ve** | **Norma e Amortizimit (%)** | | **Metoda e Llogaritje** |
|---|---|---|---|
| | **2018** | **2017** | |
| Ndertesa | 1.5% | 5% | Mbi vleren e mbetur |
| Instalime Teknike Specifike | 1.5% | 5% | Mbi vleren e mbetur |
| Instalime Teknike Komplekse | 1.5% | 20% | Mbi vleren e mbetur |
| Makineri e Paisje Pune | 20% | 20% | Mbi vleren e mbetur |
| Mjete transporti | 20% | 20% | Mbi vleren e mbetur |
| Mobilje dhe Paisje zyre | 20% | 20% | Mbi vleren e mbetur |
| Pajisje informatike | 25% | 25% | Mbi vleren e mbetur |

e. **Provizionet**

Nje provizion krijohet nese ekziston nje detyrim ligjor ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve te kaluara; ekziston mundesia qe per shlyerjen e detyrimit dhe nese mund te beht nje vleresim relativisht i sakte i shumes se detyrimit.

f. **Te Ardhurat**

Te ardhurat regjistrohen sipas mases se realizimit te tyre dhe lidhjes qe ato kane me ushtrimin e mbyllur kontabel, pamvaresisht nese arketimi i tyre apo i nje pjese prej tyre do te ndodhe ne nje ushtrim pasardhes. Te ardhurat nga interesat regjistrohen ne momentin e maturimit te tyre.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve te veta.

g. **Tatimi mbi fitimin**

Tatimi aktual mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me dispozitat e ligjit "Per tatimin mbi te Ardhurat ne Republiken e Shqiperise" duke perfshire gjithe detyrimet per tatimin mbi fitimin te pagueshme per vitin ushtrimor. Tatimet aktuale jane tatime per tu paguar qe rezultojne nga te ardhurat e tatueshme, duke perdorur shkallen tatimore qe eshte ne fuqi ne daten e bilancit, dhe çdo rregullim ne tatimet per tu paguar qe rrjedh nga vitet e kaluara.

Shkalla tatimore per tatimin mbi fitimin per vitin ushtrimor eshte **15%**.

h. **Kontributet per Sigurimet dhe Fondi i pensioneve**

Shoqeria paguan kontributet per pensione si edhe kontribute per sigurime shendetsore per punonjesit e saj sic eshte parashikuar ne legjislacionin social ne Shqiperi. Kontributet, bazuar ne pagat, jane paguar ne llogari te organizmave kombetare pergjegjes per pagesen e pensioneve dhe shpenzimeve shendetesore. Nuk ka asnje detyrim tjeter ne lidhje me fondin per pensione dhe shpenzime shendetesore.

| 4 | **Mjete Monetare** | ***2,018*** | ***2,017*** |
|---|---|---|---|
| | | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Llogari bankare | 10,583,062 | 7,123,845 |
| | Deposita ne banke | | 10,000,000 |
| | | **10,583,062** | **17,123,845** |

| 5 | **Aktive te tjera Financiare afatshkurter** | ***2,018*** | ***2,017*** |
|---|---|---|---|
| | ***(Nga aktiviteti i shfrytëzimit)*** | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Kliente per sherbime (Studentet) | **634,337** | **633,599** |

| 6 | **Aktive te tjera Financiare afatshkurter** | ***2,018*** | ***2,017*** |
|---|---|---|---|
| | ***(Të tjera)*** | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Tatim fitimi | 92,214 | 92,214 |
| | Shteti-TVSH per tu marre | 7,101,748 | 7,101,748 |
| | Shteti-Kontribute Shoqerore per tu marre | | |
| | Kliente per sherbime (Studentet) | | |
| | | **7,193,962** | **7,193,962** |

| 7 | **Inventari** | ***2,018*** | ***2,017*** |
|---|---|---|---|
| | | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Materiale te para dhe te konsumueshme | 994,652 | 729,480 |
| | Inventar I imet | 1,530,175 | 1,444,893 |
| | Konsum I inventarit te imet | (492,971) | (492,971) |
| | | **2,031,856** | **1,681,403** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **9** | **Detyrime afatshkurtra** | ***2,018*** | ***2,017*** |
| | ***(Titujt e huamarrjes)*** | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Arkëtimet në avancë për porosi (nga studentet) | **1,945,600** | **4,119,200** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **10** | **Detyrime afatshkurtra** | ***2,018*** | ***2,017*** |
| | ***(Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit)*** | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Furnitore (OSHEE,Ujesjelles) | 465,929 | 708,484 |
| | Parapagime nga qiramarresit | 685,732 | 814,516 |
| | | **1,151,661** | **1,523,000** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **11** | **Detyrime afatshkurtra** | ***2,018*** | ***2,017*** |
| | ***(Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve)*** | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Detyrime per Paga personeli | | 707,876 |
| | Detyrime per Paga Keshilli Mbikqyres | 76,330 | 72,080 |
| | | **76,330** | **779,956** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **12** | **Detyrime afatshkurtra** | ***2,018*** | ***2,017*** |
| | ***(Të pagueshme për detyrimet tatimore)*** | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Sigurimet Shoqerore | 219,600 | 228,983 |
| | Tatim mbi te ardhurat e personale | 24,830 | 20,930 |
| | Tatim ne burim | 13,470 | 12,720 |
| | | **257,900** | **262,633** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **13** | **Detyrime afatshkurtra** | ***2,018*** | ***2,017*** |
| | ***(Të ardhura të shtyra)*** | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Te ardhura te shtyra nga grantet | | **3,665,902** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **14** | **Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit** | ***2,018*** | ***2,017*** |
| | | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Shitje sherbimesh hotelerie per studentet | **5,821,600** | **7,156,920** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **15** | **Të ardhura te tjera te shfrytëzimit** | ***2,018*** | ***2,017*** |
| | | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Qira nga objektet e shoqerise | 996,889 | 692,941 |
| | Qira, subvencione, interesa etj | | |
| | | **996,889** | **692,941** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **16** | **Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme** | ***2,018*** | ***2,017*** |
| | | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Blerje /shpenzime te materialeve te tjera | (1,610,729) | (1,201,143) |
| | **Totali** | **(1,610,729)** | **(1,201,143)** |

| 17 | **Shpenzime të personelit** | ***2,018*** | ***2,017*** |
|---|---|---|---|
| | | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Paga dhe shpërblime | (9,372,791) | (9,405,977) |
| | Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore | (1,566,746) | (1,545,343) |
| | | **(10,939,537)** | **(10,951,320)** |

| 18 | **Shpenzime konsumi dhe amortizimi** | ***2,018*** | ***2,017*** |
|---|---|---|---|
| | | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Amortizimi AAM | | |
| | - Shpenz. amortizimi per ndertesa | (2,101,533) | (7,257,594) |
| | - Shpenz. amortizimi per makineri dhe paisje | (1,472,951) | (1,519,102) |
| | - Shpenz. amortizimi per mjete transporti | (262,811) | (289,866) |
| | - Shpenz. amortizimi per orendi dhe pajisje zyre | (210,155) | (193,935) |
| | - Shpenz. amortizimi per paisje informatike | (56,168) | (89,535) |
| | **Totali** | **(4,103,618)** | **(9,350,032)** |

| 19 | **Shpenzime të tjera shfrytëzimi** | ***2,018*** | ***2,017*** |
|---|---|---|---|
| | | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Energji + uje | (4,569,142) | |
| | Sherbim ruajtje godine | (4,924,133) | |
| | Shpenzime gjyqesore | (2,378,320) | |
| | Sherbim pastrimi | (1,605,602) | |
| | Paga per Keshillin Mbikqyres | (1,029,872) | |
| | Sherbim auditimi | (576,000) | |
| | Sherbim dizifektim dhe lyerje me boje | (629,520) | |
| | Taksa +Siguracion +Servis makina | (192,170) | |
| | Te ndryshme | (190,313) | |
| | Sherbim interneti | (118,918) | |
| | Sherbim remont Kaldaje+Riparim pajisje elektronike | (188,123) | |
| | Komisione bankare | (40,950) | |
| | Udhetime dhe dieta | (11,110) | |
| | **Totali** | **(16,454,173)** | **(17,247,708)** |

| 20 | **Të ardhura të tjera** | ***2,018*** | ***2,017*** |
|---|---|---|---|
| | | ***ALL*** | ***ALL*** |
| | Interesa nga depozita bankare | 150,296 | 156,591 |
| | Subvencuione nga Ministria e Arsimit | 19,431,310 | 18,979,619 |
| | Te ardhura nga grantet | 3,665,902 | 7,390,000 |
| | Te ardhura nga dembshperlime nga te trete | 272,651 | 20,445 |
| | Te ardhura te tjera financiare | | 13,298 |
| | | **23,520,159** | **26,559,953** |

| 21 | **Shpenzime Financiare** | ***2,018*** | ***2,017*** |
|---|---|---|---|
| | | ***ALL*** | ***ALL*** |

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA FINANCAVE DHE EKONOMISE TRAJTIMI STUDENTEVE SH.A. - SHKODER

| | | |
|---|---|---|
| Shpenzime te tjera financiare (KM) | (89,800) | (84,800) |

## TRAJTIMI STUDENTEVE SHA, SHKODER

**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**

**Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2017**

| 22 **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | ***2,018*** ***ALL*** | ***2,017*** ***ALL*** |
|---|---|---|
| **Rezultati Ushtrimor** | (2,859,209) | (5,282,257) |
| Shpenzime te panjohura per efekte fiskale | | |
| Humb.nga mosark.kerk.treteve | | |
| Gjoba dhe demshperblime | | |
| Diferenca ne arketim / pagesa | | |
| Shpenzime te periudhave te kaluara | | |
| Shpenzime per interesa | | |
| **Efekti i Korigjimeve te rezultatit Ushtrimor** | | |
| **Rezultati Tatimor** | (2,859,209) | (5,282,257) |
| **% e Tatim Fitimi** | 15% | 15% |
| **Tatimi Mbi Fitimin** | | |

**Hartuesi I Pasqyrave Financiare**
**dhe Shenimeve Shpejguese**

**Pergj. Sek.Ekonomik**
**Edri KAZAZI**

**Administratori**

**Jetmir LUMAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TRAJTIMI STUDENTËVE SH.A SHKODËR

## TRAJTIMI STUDENTEVE SHA, SHKODER

Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2018

8 Aktivet Afatgjat Materiale dhe JoMateriale

| Pershkrimi | | | Toke | Ndertesa | Makineri dhe Pajisje | Automjetet | Pajisje Zyre | Pajisje Kompjuterike | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 5% | 20% | 20% | 20% | 25% | |
| Bilanci i Celjes dt 01.01.2018 | AQT Vlera Bruto | + | | 336,614,787 | 43,137,013 | 4,410,000 | 2,524,462 | 1,239,908 | 387,926,170 |
| Bilanci i Celjes dt 01.01.2018 | Amortiz Akumul | - | | (196,512,561) | (36,227,055) | (3,095,942) | (1,533,689) | (1,015,234) | (238,384,481) |
| Bilanci i Celjes dt 01.01.2018 | Provizione | + | | | | | | | |
| Bilanci i Celjes dt 01.01.2018 | VLERA NETO | | | 140,102,226 | 6,909,958 | 1,314,058 | 990,773 | 224,674 | 149,541,689 |
| Hyrjet 2018 | Vlera Bruto | + | | | 454,800 | | 60,000 | | 514,800 |
| Daljet 2018 | Vlera Bruto | - | | | | | | | |
| Riklasifikim i Aktiveve | | + / - | | | | | | | |
| Amortizimi i Vitit Ushtrimor | | - | | (2,101,533) | (1,472,951) | (262,811) | (210,155) | (56,168) | (4,103,618) |
| Provizionet | | + | | | | | | | |
| Rimarje e Amortizimit | | + | | | | | | | |
| Rimarje e Provizioneve | | - | | | | | | | |
| Riklasifikim i Amortizimeve | | + / - | | | | | | | |
| Bilanci i Mbylljes 31.12.2018 | AQT Vlera Bruto | | | 336,614,787 | 43,591,813 | 4,410,000 | 2,584,462 | 1,239,908 | 388,440,970 |
| Bilanci i Mbylljes 31.12.2018 | Amortiz Akumul | | | (198,614,094) | (37,700,006) | (3,358,753) | (1,743,844) | (1,071,402) | (242,488,099) |
| Bilanci i Mbylljes 31.12.2018 | Provizione | | | | | | | | |
| Bilanci i Mbylljes 31.12.2018 | VLERA NETO | | | 138,000,693 | 5,891,807 | 1,051,247 | 840,618 | 168,506 | 145,952,871 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË - TRAJTIMI STUDENTËVE SH.A. SHKODËR